



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:051907
Datë: 20.03.2024
Numri i dokumentit: 05477320

CAP.nr.440/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm–Divizioni Civil, gjyqtari individual Ylber Shurdhiqi, në çështjen juridike–përmbaremore të kreditorit K.R.U. “H.J” me seli në Prizren, rruga “W. C” p.n., kundër debitorit A.B. nga Prizreni, rruga “Pjetër Loshi”, p.n., lidhur me çështjen përmbaremore, për borxh, duke vendosur sipas ankesës së kreditorit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prizren, PPP.nr.39/22, të datës 01.03.2023, me datë 20.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET e bazuar ankesa e kreditorit K.R.U. “H.J” me seli në Prizren, rruga “W. C” p.n., PRISHET aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prizren, PPP.nr.39/22, të datës 01.03.2023, dhe lënda i kthehet të njëjtës gjykatë në rishqyrtim dhe vendosje.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin e ankimuar PPP.nr.39/22, të datës 01.03.2023, në pikën I të dispozitivit e ka aprovuar pjesërisht të bazuar, prapësimin e debitorit të përmbaremit A.B. nga Prizreni, ushtruar kundër urdhrin për përmbaremit, P.nr.108/2022 të datës 03.03.2022, të përmbaremit privat R. H nga Prizreni, për pjesën e detyrimit në të holla në shumën prej 889.88 euro. Në pikën II të dispozitivit e ka shfuqizuar pjesërisht, urdhrin për përmbaremit P.nr.108/2022 të datës 03.03.2022, të përmbaremit privat R.H nga Prizreni, për pjesën e detyrimit në të holla në shumën prej 889.88 euro, ndërsa e ka lërë në fuqi të njëjtin urdhër për përmbaremit, për pjesën e detyrimit në të holla në shumën prej 78.5 euro. Në pikën III të dispozitivit ka vendosur që pjesa tjetër e prapësimit të debitorit të përmbaremit A.B. nga Prizrenii, ushtruar kundër urdhrin për përmbaremit, P.nr.108/2022 të datës 03.03.2022, të përmbaremit privat R. H nga Prizreni, për pjesën e detyrimit në të holla në shumën prej 78.5 euro, të refuzohet i pabazuar.

Kundër këtij aktvendimi kreditori brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatim të gabuar të dispozitave materiale, me

propozim që aktvendimi i ankimuar të anulohet dhe të refuzohet prapësimi i debitorit ashtu që lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

Debitori nuk ka parashtruar përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194, 208 dhe 209 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore, ka gjetur se:

Ankesa e kreditorit është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se Kreditori, me datë 03.03.2022 ka parashtruar propozim për lejimin e përmbartimit kundër debitorit, për pagesën e borxhit në emër të shpenzimit të ujit në shumën prej 968.38 euro. Përmbartuesi Privat me urdhrin P.nr.108/22, të datës 03.03.2022 e ka lejuar përmbartimin sipas propozimit të kreditorit.

Kundër këtij urdhri mbi lejimin e përmbartimit, Debitori në afat ligjor ka ushtruar prapësim, me të cilin e ka kundërshtuar urdhrin e Përmbartuesit Privat, duke e kundërshtuar në tërësi borxhin e kreditorit, me arsyetimin se borxhi është i parashkruar konform nenit 360 të LMD-së, duke propozuar aprovimin e prapësimit dhe anulimin e urdhrin për lejimin e përmbartimit.

Kreditori, brenda afatit ligjor ka parashtruar përgjigje në prapësimin e debitorit, duke i kundërshtuar pretendimet e debitorit në prapësimin e ushtruar dhe duke i propozuar gjykatës që prapësimin e debitorit ta refuzoj si të pabazuar.

Gjykata e shkallës së parë pas vlerësimit të prapësimit dhe përgjigjes në prapësim me aktvendimin e ankimuar PPP.nr.39/22, të datës 01.03.2023, në pikën I të dispozitivit e ka aprovuar pjesërisht të bazuar, prapësimin e debitorit të përmbartimit A.B. nga Prizreni, ushtruar kundër urdhrin për përmbartim, P.nr.108/2022 të datës 03.03.2022, të përmbartuesit privat R.H nga Prizreni, për pjesën e detyrimit në të holla në shumën prej 889.88 euro. Në pikën II të dispozitivit e ka shfuqizuar pjesërisht, urdhrin për përmbartim P.nr.108/2022 të datës 03.03.2022, të përmbartuesit privat R.H. nga Prizreni, për pjesën e detyrimit në të holla në shumën prej 889.88 euro, ndërsa e ka lërë në fuqi të njëjtin urdhër për përmbartim, për pjesën e detyrimit në të holla në shumën prej 78.5 euro. Në pikën III të dispozitivit ka vendosur që pjesa tjetër e prapësimit të debitorit të përmbartimit A.B. nga Prizreni, ushtruar kundër urdhrin për përmbartim, P.nr.108/2022 të datës 03.03.2022, të përmbartuesit privat R. H nga Prizreni, për pjesën e detyrimit në të holla në shumën prej 78.5 euro, të refuzohet i pabazuar, duke vendosur më saktësisht si në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar.

Në arsyetim të aktvendimit të ankimuar, gjykata e shkallës së parë ka theksuar gjykata ka vlerësuar dhe marrë për bazë pjesërisht pretendimin e debitorit të theksuar në prapësimin e tij, në të cilin ka cekur njërin nga shkaqet e parapara për prapësim sipas nenit 71 par. 1 pika 4 të LPP-së, në të cilin theksohet që *“prapësimi mund të bazohet vetëm nëse ka skaduar afati kohor brenda të cilit, sipas ligjit, mund të kërkohet përmbartimi”*, lidhur me nenin 360 par. 1 nën par. 1 të LMD-së, në të cilin përshkruhet se *“kërkesat të cilat parashkruhen pas një (1) viti, kërkesat për furnizimin e energjisë elektrike, energjisë termike, gazit, ujit dhe shërbimet e pastrimit të*

oxhaqeve dhe për mirëmbajtjen e shërbimit të pastërtisë, nëse furnizimi ose shërbimi është kryer për nevojat shtëpiake". Pra, këto dispozita ligjore parashohin skadimin e afatit kohor për të kërkuar përmbarimin dhe i cili shkak do ta pengonte përmbarimin e kredisë - detyrimit në të holla në këtë çështje juridike të përmbarimit.

Gjithashtu, gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e palës kreditore, ku ka theksuar se, debitori ka bërë disa pagesa, me të cilat veprime ka ndërprerë parashkrimin sipas nenit 368 të LMD-së, në të cilën dispozitë ligjore përcaktohet që *"parashkrimi ndërpritet kur debitori e pranon borxhin. Pranimi i borxhit mund të bëhet jo vetëm me deklaratën e kreditorit, veçse edhe në mënyrë të tërthortë, sikurse janë pagesa e këstit, pagesa e kamatës, dhënia e sigurimit"*. Pra, nga kjo dispozitë ligjore parashihet ndërprerja e parashkrimit, respektivisht mënyra si mund të ndërpritet rrjedhja e afatit të parashkrimit. Andaj, nga analizimi i pretendimeve të palëve ndërgjyqjese, gjykata ka ardhur në përfundim se që të dyja janë pjesërisht të bazuara për arsyet e cekura në vijim, dhe me këtë rast ka vendosur sikurse në pikën nën I., II., III. të dispozitivit të aktvendimit, duke aprovuar pjesërisht prapësimin e palës debitor dhe shfuqizuar e lënë pjesërisht në fuqi urdhrin e lartcekur për përmbarim.

Ka shtuar se më konkretisht, shkak i cëkur nga pala debitor, është pjesërisht i bazuar për një pjesë të detyrimit në të holla, kurse pjesërisht i pa bazuar për pjesën tjetër të detyrimit në të holla. Kështu, sikurse është precizuar në dispozitiv të këtij aktvendimi, bazuar në nenin 360 par. 1 të LMD-së lidhur me nenin 368 të LMD-së, pala debitor me pagesën që ka bërë më datë 03.12.2018, në shumë prej 13.00 euro, ka ndërprerë parashkrimin në periudhë paraprake 1 vjeçare dhe në periudhë pasuese 1 vjeçare. Po ashtu, gjykata vlerësoi se përkundër pagesave të bëra përsëri ka filluar të rrjedhë afati i parashkrimit, ngase pala debitor që nga momenti i pagesës së fundit me datë 03.12.2018, nuk ka bërë asnjë pagesë, dhe afati i parashkrimit përsëri ka rrjedhë deri në momentin e inicimit të procedurës së përmbarimit me dt. 03.03.2022, e që parashkrimin e ka ndërprerë për një periudhë paraprake 1 vjeçare. Gjykata po ashtu vlerësoi edhe faktin e kontratës për pagesën e borxhit me këste të lidhur ndërmjet palëve në këtë procedurë me datë 31.08.2018, ku pala debitor me nënshkrimin e borxhit ka pranuar detyrimin ndaj palës kreditore, mirëpo fakti që kjo kontratë nuk është përmbushur sipas ratave të përcaktuara në kontratë, përsëri ka filluar të rrjedhë afati i parashkrimit, ngase pala kreditore që nga momenti i lidhjes së kontratës e deri në inicimin e procedurës së përmbarimit, ka kaluar periudhë e gjatë kohore. E që nënkupton se detyrimi i palës debitor ndaj palës kreditor deri më datë 28.02.2021 është parashkuar.

Ndërsa, lidhur me pretendimet e palës kreditore, se në rastin konkret me marrëveshjen për pagimin e borxhit është ndërprerë afati i parashkrimit, gjykata konsideron se në rastin konkret përkundër faktit se palët me marrëveshjen e arritur e kanë ndërprerë parashkrimin, parashkrimi përsëri ka filluar të rrjedhë, ngase në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me heqje dorë nga parashkrimi, pasi që palët janë pajtuar për pagesën e detyrimit i cili nuk ka qenë i parashkuar, që rrjedhimisht përkundër ndërprerjes së parashkrimit me arritjen e marrëveshjes, parashkrimi përsëri ka filluar të rrjedhë.

Më saktësisht, nga faktet dhe arsyet e cekura më lartë, pala kreditore ka të drejtën e të kërkuarit të përmbushjes së detyrimit në shumën prej 78.5 euro dhe pala debitor është e obliguar ta

përmbushë këtë shumë, ndërsa pala kreditore ka humbur të drejtën e të kërkuarit të përmbushjes së detyrimit në shumën prej 889.88 euro, sepse kjo pjesë e kërkesës të detyrimit në të holla është parashkuar.

Vlerësimin dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë sipas aktvendimit të ankimuar, Gjykata e Apelit nuk mund ta pranojë si të rregullt dhe të ligjshëm, për shkak se aktvendimi i ankimuar është marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragraf 1 e lidhur me nenin 160 paragraf 4, të Ligjit të Procedurës Kontestimore, si dhe lidhur me nenin 4, 17, 29 dhe 73 të Ligjit të Procedurës Përmbartimore. Në këtë rast gjykata e shkallës së parë nuk i është përmbajtur dispozitave të cituara për arsyetimin e aktvendimit sepse nuk ka paraqitur në mënyrë të strukturuar dhe të kuptueshme cilat kanë qenë kërkesat e palëve respektivisht kundërshtimet, cilat kanë qenë faktet vendimtare, cilat prova janë shfrytëzuar për vërtetimin e fakteve dhe si janë vlerësuar ato dhe si pasojë ka dështuar të nxjerrë një vendim të drejtë dhe të ligjshëm.

Me nenin 29 paragraf 1, pika 1.2 të LPP-së, përcaktohet se: *“Dokument i besueshëm sipas këtij ligji, janë ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave”*. Në këtë rast në shkresat e lëndës si prova materiale gjendet ekstrakti nga librat afariste Kartela e konsumuarit për datën 01.01.2011-31.01.2022, ndërsa nga raporti i llogarisë për konsumatorin llogaritjet qarkullimi për periudhën raportuese nga data 31.01.2015 deri me datë 27.01.2022.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, gjykata e shkallës së parë me vlerësim jo të plotë dhe të gabuar të fakteve të çështjes, ka zbatuar në mënyrë të gabuar dispozitat ligjore të LPP-së dhe LMD-së për arsye se në këtë rast gjykata e shkallës së parë, nuk ka arsyetuar faktet vendimtare sa i përket periudhës kohore, përkatësisht se për cilën periudhë kohore kërkohet përmbushja e detyrimit nga ana e debitorit, sa ka qenë ajo shumë, a ka paguar debitori borxhin për atë periudhë kohore, a e ka pranuar borxhin kreditori, dhe a ka pasur marrëveshje për programim të borxhit ndërmjet kreditorit dhe debitorit, fakte këto të domosdoshme për një vendim të drejtë dhe të ligjshëm.

Po ashtu sa i përket parashkrimit gjykata e shkallës së parë ka dhënë një arsyetim lidhur me parashkrimin, por për gjykatën e shkallës së dytë nuk mund të kuptohet se si ka ardhur deri te një vendosje e tillë lidhur me parashkrimin, pasi debitori në prapësimin e paraqitur është thirrur në institutin e parashkrimit duke theksuar se borxhi është vjetërsuar, andaj në këtë rast me vet faktin e mos përcaktimit të periudhës kohore brenda të cilës është kërkuar përmbushja e detyrimit nënkupton faktin tjetër edhe mos mundësinë e llogaritjes së parashkrimit të kërkesës si pretendim i palës debitore.

Të gjeturat dhe konstatimet e bëra si më lartë nga gjykata ankimore, aktvendimin e ankimuar e bëjnë jo të drejtë dhe pa mbështetje në ligj, andaj ka qenë e domosdoshme që të anulohet dhe lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë, në rishqyrtim dhe vendosje.

Në riprocedurë, gjykata e shkallës së parë udhëzohet që të bëjë eliminimin e shkeljeve të dispozitave të procedurës përmbartimore në pajtim me vërejtjet e paraqitura, të konstatoj se për cilën periudhë kohore konkretisht kërkohet përmbushja e detyrimit, sa ka qenë ai detyrim dhe a është paguar për atë periudhë kohore, a ka pasur riprogramim të borxhit, pastaj të bëjë vlerësimin

sa i përket parashkrimit të kërkesës duke marr për bazë të gjeturat e Gjykatë së Apelit, e në përputhje me natyrën e kërkesës dhe dispozitat materiale, të cilat i referohen parashkrimit të kërkesave për bazë të njëjtë, siç është objekti përmbartimit, duke pasur parasysh gjithashtu që me rastin e vendosjes meritore, pa marrë parasysh cili do të jetë përfundimi lidhur me çështjen lëndore, të evitohet shkeljet procedurale të konstatuara si me lartë nga gjykata ankimore, ashtu që gjykata e shkallës së parë në rastin konkret duhet që propozimin për përmbartim t'ia kthejë kreditorit në plotësim konform nenit 102 të LPK-së, në mënyrë që të përcaktohet nga kreditori periudha kohore për të cilën kërkohet përmbartimi, e pastaj gjykata të vlerësojë parashkrimin sipas propozimit për përmbartim.

Mbi bazën e shkeljeve të konstatuara si më lartë, kjo gjykatë gjeti se aktvendimi i ankimuar duhet prishur dhe çështja duhet kthyer në rivendosje tek gjykata e shkallës së parë, pasi që në rastin konkret nuk ka pasur kushte që i njëjti aktvendim të mund të ndryshohej nga ana e gjykatës së shkallës së dytë.

Kompetenca e Gjykatës së Apelit për të vendosur nga ana e gjyqtari individual në shkallë të dytë bazohet në dispozitën e nenit 3 par. 2 të LPP, me të cilën është paraparë se në procedurën përmbartimore *"në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual"*.

Nga arsyet e paraqitura me lartë, gjykata e shkallës së dytë vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, në pajtim me nenin 208 e 209 pika (d) të LPK, e lidhur me nenin 17 dhe 77 të LPP-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PPISHTINË
CAP.nr.440/2023, datë 20.03.2024

G j y q t a r i,
Ylber Shurdhiqi